

Република Северна Македонија  
**Министерство за правда**



Republika e Maqedonisë së Veriut  
**Ministria e Drejtësisë**

# Raporti vjetor 2022 mbi zbatimin e Ligjit për ndihmën juridike falas



**Ministria e Drejtësisë**  
**Republika e Maqedonisë së Veriut**





# Raporti vjetor 2022 mbi zbatimin e Ligjit për ndihmën juridike falas

Shkup, 2023

Bashkëfinancuar nga  
Bashkimi Evropian



BASHKIMI EVROPIAN

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Bashkëfinancuar dhe zbatuar  
nga Këshilli i Evropës

Ky dokument u prodhua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autorit(ve). Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të konsiderohen në asnjë mënyrë se pasqyrojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian apo të Këshillit të Evropës.



## PËRMBAJTJA

<i>Fjalim hyrës</i> .....	6
<i>nga Udhëheqësi i Seksionit për ndihmë juridike falas</i> .....	6
Hyrje .....	8
Korniza juridike dhe korniza institucionale.....	9
Korniza juridike.....	9
Korniza institucionale.....	10
Të dhënat statistikore për ndihmë juridike falas në 2021.....	13
Ndihma juridike parësore.....	13
Ndihma dytësore juridike.....	17
Tregime të suksesshme.....	18
Buxheti dhe të dhënat financiare.....	19
Ekipimi teknik.....	20
Ndarja e mjeteve financiare për dhënie të ndihmës juridike parësore nga shoqatat e autorizuara dhe klinikat juridike .....	20
Aktivitetet për promovimin dhe informimin e publikut për ndihmën juridike falas.....	26
Trupi Koordinues Kombëtar për zbatimin e Ligjit për ndihmën juridike falas.....	29
Trajnimet e punonjësve .....	31
Analizat dhe kërkimet .....	34
Anekset .....	37



## PARAFJALIM:

*Nga Sekretari Shtetëror pranë Ministrisë së Drejtësisë*



*„Të sigurohet ndihmë juridike vërtet kushton shtrenjtë, por më shtrenjtë do të kushtonte mos sigurimi i ndihmës juridike“*

*Raporti vjetor për zbatimin e Ligjit për ndihmën juridike falas është një nxitje e plotë për Qasje të barabartë në drejtësi efektive dhe Forcimin e ndikimit të qytetarëve në reformat efektive në sistemin juridik.*

*Qëllimi i Raportit Vjetor është njohja e qytetarëve me aktivitetet e Ministrisë së Drejtësisë, konkretisht aktivitetet e Njësisë për ndihmë juridike falas, në të cilin mund të gjenden të dhëna të dobishme për qytetarët.*

*Për momentin, Ministria e Drejtësisë ka gjithsej 34 Njësi rajonale për ndihmë juridike falas, 15 Shoqata janë të regjistruara në regjistrin për ndihmë juridike falas dhe 7 klinika juridike.*

*Qytetarët duhet të gjejnë shërbime falas, personale, të pavarura, të besueshme dhe të paanshme, të cilave mund t'u besojnë. Megjithatë, në rrethana të caktuara është e patjetërsueshme të thellohem në rrethanat individuale të rastit dhe të gjendet një zgjidhje ballë për ballë.*

*Në çdo rast, qytetarët duhet të fitojnë shërbime dhe kujdes të cilësisë së lartë.*

*Qëllimi kryesor i Ministrisë së Drejtësisë është që përmes raportit vjetor të mund të kontribuojë në krijimin e një gjyqësori të pavarur, të paanshëm, efikas, cilësor dhe transparent, ime çka do të mundësohet mbrojtja adekuatë e interesit publik.*



*Objektivat specifike përfshijnë kontributin në ndërtimin e një sistemi efektiv të ndihmës juridike dhe rritjen e kapaciteteve ekzistuese të përfaqësuesve të institucioneve përkatëse për ligjin për ndihmën juridike falas.*

*Ky raport duhet t'u shërbejë qytetarëve që të informohen se në çfarë mënyre mund t'i realizojnë të drejtat e garantuara me Kushtetutë përmes Ligjit për ndihmë juridike falas.*

*Përdoruesit përfundimtarë duhet të jenë qytetarët, grupet e cënueshme dhe të marginalizuara të shoqërisë.*

*Do ta mbyll mendimin me një fjali:*

*“Pa qasje të barabartë në ligj, sistemi jo vetëm që i privon të varfërit nga mbrojtja e tyre e vetme, por u jep shtypësve të tyre armën më të fuqishme dhe më të pamëshirshme të krijuar ndonjëherë”.*

*Mr. Muhamed Tochi*

*Sekretari Shtetëror pranë Ministrisë së Drejtësisë*



## Fjalim hyrës

*nga Udhëheqësi i Seksionit për ndihmë juridike falas*



Qëllimi im si Udhëheqës seksioni për ndihmë juridike falas është që sigurohemi se njerëzit në shtetin tonë i kuptojnë të drejtat e tyre ligjore dhe njerëzit e privuar nga e drejta kanë qasje në shërbime juridike cilësore. Të angazhohemi për gjykim të drejtë në sistemin tonë të drejtësisë dhe të sigurojmë qasje në drejtësi për të gjithë.

*Sistemi i ndihmës juridike falas ofron mbrojtje të të drejtave të njeriut, e me atë edhe e garanton barazinë ndërmjet njerëzve në rendin juridik. Esenca e Ndhimës juridike falas është në atë ajo është mbrojtëse e të drejtave më së shpeshti e të dobëtëve dhe atyre qytetarëve që nuk mund të lejojnë t'i bartin shpenzimet në procedurat për realizimin e të drejtave të tyre, ose për ato që nuk kanë njohuri të mjaftueshme të të drejtës.*

Në territorin e shtetit tonë kemi 34 zyra rajonale, dhe punojmë në rrethana sfiduese unike. Meqë bëhet fjalë për popullsi me distancë gjeografike nga qendrat, në kushte krize dhe vështirësi ekonomike, NE insistojmë që ta njoftojmë popullsinë me normat juridike dhe risitë në dispozitat ligjore.

Vlerat tona janë: drejtësia sociale dhe drejtësia që vlerëson diversitetin në kulturë, kombësinë dhe përkatësinë etnike; Njohja e kombësive dhe vlerësimi i komunitetit tonë multikulturor; Integriteti të cilin ne e kultivojmë

*Si shtet duhet të vazhdojmë të synojmë ta përhapim gamën e ndihmës juridike falas, e me atë edhe të sigurojmë mbrojtje më të madhe të të drejtave të njeriut.*





*duke i kryer funksionet tona me respekt, dinjitet, ngushëllim dhe ndershmëri; Profesionalizmi, i përkushtuar ndaj shtetit të së drejtës, standardeve etnike, inovacionit, rishikimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm për të siguruar shërbim cilësor; Përgjegjësia - ne jemi përgjegjës për veprimet dhe vendimet; Qëndrueshmëria - mjedis pune i sigurt dhe mbështetës.*

*Seksioni për ndihmë juridike falas pranë Ministrisë së Drejtësisë shënon 85% tregime të suksesshme, procedura të kryera me sukses për poseduesin e ndihmës juridike falas. Të gjitha këto reagime të suksesshme dëshmojnë për punën e suksesshme dhe funksionimin e suksesshëm të sistemit për ndihmë juridike falas në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe për cilësinë e punës së të punësuarve në Ministri dhe në seksionet rajonale*

*Vesna Nakovska*

*Udhëheqës seksioni për ndihmë juridike falas*



## Hyrje

Raporti vjetor për zbatimin e Ligjit për ndihmë juridike falas 2022 ka për qëllim ta ndjekë procesin e implementimit dhe zbatimit të Ligjit për ndihmë juridike falas ("Gazeta zyrtare e RMV-së" nr. 101/19) në periudhën nga 01 janar 2022 deri në 31 dhjetor 2022.

Ky raport është përgatitur në pajtim me nenin 44 të Ligjit për ndihmë juridike falas ("Gazeta zyrtare e RMV-së" nr. 101/19). Ministria e Drejtësisë përgatit Raport vjetor për ndihmë juridike falas për aktivitetet lidhur me sigurimin e ndihmës juridike dhe atë ia dorëzon Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut si dhe e publikon në ueb faqen e saj.

Raporti veçanërisht përfshin veçanërisht të dhëna për:

- Numri i personave të cilëve iu është dhënë ndihma juridike parësore;
- Numri i kërkesave të paraqitura për ndihmë juridike dytësore;
- Numri i kërkesave të miratuara për ndihmë juridike dytësore;
- Numri i kërkesave të refuzuara për ndihmë juridike dytësore;
- Numrin e vendimeve të marra me të cilat ndërprehet ndihma juridike dytësore e miratuar;
- Çështjen juridike për të cilën miratohet ose refuzohet ndihma juridike;
- Numri i shoqatave që ofrojnë ndihmë juridike parësore;
- Numri i klinikave juridike që ofrojnë ndihmë juridike parësore;
- Numri i avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike dytësore;
- Buxheti i destinuar për ndihmë juridike falas;
- Shuma e mjeteve të paguara për ndihmë juridike falas;
- Shuma e mjeteve të kthyer nga shpenzimet e mbledhura për ndihmë juridike.

Përgatitja e raportit vjetor si dhe procesi i mbledhjes së informatave dhe të dhënave është në bashkëpunim të ngushtë me Seksionet rajonale pranë Ministrisë së Drejtësisë, Shoqatave të qytetarëve të autorizuar për ofrim të ndihmës juridike falas dhe Klinikat juridike.



## Korniza juridike dhe korniza institucionale

### Korniza juridike

Ligji për ndihmën juridike falas (“Gazeta zyrtare e RMV-së” nr. 101/19) zbatohet nga 1 tetor 2019, me këtë ligj rregullohen rregullat e përgjithshme për ofrimin e ndihmës juridike falas, llojet, gama e ndihmës juridike falas, ofruesit dhe përfituesit e ndihmës juridike falas, detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre, procedura në të cilën ushtrohet e drejta e ndihmës juridike falas, financimi, dhënia dhe kompensimi i shpenzimeve për ndihmën juridike falas të ofruar, ndihma juridike falas në kontestet ndërkufitare, transparenca dhe llogaridhënia në dhënien e ndihmës juridike falas, procedurat e veçanta për ndihmën juridike, mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji dhe çështje të tjera që lidhen me ndihmën juridike falas. Qëllimi i këtij ligji është të mundësojë dhe avancojë të drejtën e personave fizike për qasje në drejtësi dhe mbrojtje të drejtë gjyqësore.

Me ligjin e ri për ndihmën juridike falas, janë përmirësuar kushtet për qasje në drejtësi në atë mënyrë që të përfitojnë ndihmë juridike falas jo vetëm qytetarët që kanë statusin e rastit social, por të gjithë personat fizikë me të ardhura të ulëta.

Persona me të ardhura të ulëta konsiderohen të gjithë ata të ardhurat mujore të të cilëve nuk janë më të mëdha se një pagë minimale neto në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Gjithashtu u mundësua ekspertiza, taksat gjyqësore dhe administrative të mbulohen nga buxheti i Ministrisë së Drejtësisë, gjë që kontribuoi në rritjen e shpejtë të qytetarëve të interesuar për ndihmë juridike falas.

Ministria e Drejtësisë miratoi dhe publikoi 17 aktet nënligjore të parashikuara në LNJF në tetor 2019. 1 Procesi i hartimit të akteve nënligjore filloi në korrik 2019 me pjesëmarrjen dhe mbështetjen e Fondacionit Shoqëri e Hapur Maqedonia dhe Shoqatës Maqedonase të Juristëve të Rinj. **Në aneksin 1** të këtij raporti është lista e të gjitha akteve nënligjore të miratuara. Aktet nënligjore grupohen sipas llojit të çështjeve që i rregullojnë dhe botohen në (“Gazetën zyrtare të RMV-së nr. 199/2019”).

---

<sup>1</sup> Aktet nënligjore u publikuan në Gazetën zyrtare të RMV-së nr. 199/2019 dhe 214/2019.



## Korniza institucionale

Aktivitetet në lidhje me ndihmën juridike falas kryhen përmes Seksionit për NJF dhe Seksioneve Rajonale në kuadër të Sektorit për Ndihmë Juridike Falas dhe Sistem Politik të Ministrisë së Drejtësisë.

Seksioni për Ndihmës Juridike Falas ka 5 të punësuar;

Më konkretisht në Seksionin për Ndihmë Juridike Falas kryhen punët dhe detyrat në vijim:

- përgatitja e propozim-ligjeve dhe rregullave tjera lidhur me ofrimin e ndihmës juridike falas;
- përgatitja e raporteve, analizave, shqyrtimeve, informacioneve dhe materialeve tjera për Kuvendin e Republikës së Maqedonisë dhe Qeverinë e Republikës së Maqedonisë dhe organet tjera, të cilat kanë të bëjnë me ofrimin e ndihmës juridike falas;
- mbajtja e evidencës së kërkesave të pranuar për ndihmë juridike falas;
- mbajtja e evidencës për kërkesat e parashtruara tek organet e tjera;
- mbajtja e regjistrave të avokatëve dhe shoqatave;
- kryerja e kontrollimit të të dhënave nga organet përkatëse;
- përgatitja e librave, formularëve dhe materialeve të tjera për nevojat e seksioneve rajonale për ofrimin e ndihmës juridike falas;
- përgatitja e aktvendimeve për regjistrim në regjistrin e avokatëve dhe në regjistrin e shoqatave;
- përgatitja e aktvendimeve për pagesën e kompensimit - për seksionin rajonal;
- monitorimi i situatës në fushën e ofrimit të ndihmës juridike falas dhe avancimi i metodës së punës; dhe
- kryen punë të tjera të përcaktuara me ligj dhe akt tjetër, e që i referohen ndihmës juridike falas.

## Seksionet rajonale

Në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut ka 21 seksione rajonale me 23 zyra, me numër total të të punësuarve 99 nga të cilat 20 janë me autorizime për nënshkrim të akteve reale – vërtetime dhe njoftime, dhe atë:




## Lista e seksioneve rajonale dhe zyrave me numër të të punësuarve

Seksionet dhe zyrat rajonale	Numri i të punësuarve	Seksionet dhe zyrat rajonale	Numri i të punësuarve
<b>1. SR Radovish dhe Berovë</b>		<b>11. SR Kërçovë</b>	<b>9</b>
- Zyra Radovish	1	<b>12. SR Ohër</b>	<b>2</b>
- Zyra Berovë	1	<b>13. SR Strugë</b>	<b>2</b>
<b>2. SR Makedonski Brod</b>	<b>1</b>	<b>14. SR Strumicë</b>	<b>2</b>
<b>3. SR Vallandovë</b>	<b>2</b>	<b>15. SR Shtipit</b>	<b>2</b>
<b>4. SR Gjevgjeli</b>	<b>2</b>	<b>16. SR Manastir</b>	<b>9</b>
<b>5. SR Makedonski Brod</b>	<b>1</b>	<b>17. SR Prilep, Demir Hisar dhe Krushevë</b>	
<b>6. SR Vallandovë</b>	<b>2</b>	- - Zyra Prilep	<b>1</b>
<b>4. SR Gjevgjeli</b>	<b>2</b>	- - Zyra Demir Hisar	<b>1</b>
<b>5. SR Vinicë dhe Koçan</b>		- - Zyra Krushevë	<b>0</b>
- - Zyra Vinicë	5	<b>18. SR Kumanovë dhe Kratovë</b>	
- - Zyra Koçan	1	- - Zyra Kumanovë	<b>6</b>
<b>6. SR Dellçevë</b>	<b>1</b>	- - Zyra Kratovë	<b>1</b>
<b>7. SR Negotinë dhe Kavadar</b>		<b>19. SR Gostivar dhe Dibra</b>	
- - Zyra Negotinë	2	- - Zyra Gostivar	<b>7</b>
- - Zyra Kavadar	1	- - Zyra Dibrës	<b>2</b>
<b>8. SR Kriva Pallanka dhe Probishtip</b>		<b>20. SR Tetovë</b>	<b>21</b>
- Zyra Kriva Pallankë	1	<b>21. SR Shkup, Karposh, Qendër, Çair, Gazi Babë dhe Kisella Voda.</b>	
- Zyra Probishtip	1	- - Zyra Karposh	<b>2</b>
<b>9. SR Resnjë</b>	<b>2</b>	- - Zyra Qendër	<b>1</b>
<b>10. SR Shën Nikollë dhe Veles</b>		- - Zyra Çair	<b>2</b>
- Zyra Shën Nikollë	2	- - Zyra Gazi Babë	<b>2</b>
- Zyra Veles	2	- - Zyra Kisella Vodë	<b>2</b>



Në seksionet rajonale kryhen punët dhe detyrat në vijim:

- kompletimi i dokumentacionit për kërkesat për ndihmë juridike falas;
- ofrimi i ndihmës juridike paraprake;
- mbajtja e evidencës së kërkesave të pranuar për ndihmë juridike falas;
- mbajtja e evidencës për kërkesat e dorëzuara tek organet tjera;
- informimi i qytetarëve për shfrytëzimin e ndihmës juridike falas;
- kryen punë tjera të përcaktuara me ligj dhe akt tjetër.



Ministria e Drejtësisë mban regjistra për ofruesit e ndihmës juridike paraprake dhe ndihmës juridike në procedurat gjyqësore dhe administrative, të cilët publikohen në faqen e internetit.

Në Regjistrin e avokatëve për ofrimin e ndihmës juridike janë regjistruar 41 avokatë të rinj, me ç'rast numri i përgjithshëm i avokatëve të regjistruar për ofrimin e ndihmës juridike deri në fund të vitit 2022 është 488 avokatë.

Ministria e Drejtësisë gjithashtu mban regjistrin e shoqatave të autorizuara për ofrimin e ndihmës parësore juridike dhe klinikave juridike të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore.

- Numri i Shoqatave të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore -15
- Numri i Klinikave të autorizuara juridike për ofrimin e ndihmës juridike parësore – 7



## Të dhënat statistikore për ndihmë juridike falas në 2021

### Ndihma juridike parësore

Ndihma juridike parësore në vitin 2022 është siguruar përmes: Seksioneve rajonale për ndihmë juridike falas të Ministrisë së Drejtësisë, përmes shoqatave të autorizuara të regjistruara në Regjistrin e Shoqatave të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike falas të Ministrisë së Drejtësisë dhe Klinikave juridike të regjistruara në Ministrinë e Drejtësisë për ofrimin e ndihmës juridike falas.

#### 1. Ndihma juridike parësore (Numri total)\*


Tabela nr. 1

	Numri total i personave që kanë marrë NJF	Gjinia		Përkatësia etnike						
		M	F	Maq	Shq	Tur	Rom	Serb	Vllah	Tjerë
Seksione rajonale	3330	1915	1316	1863	731	232	257	5	0	15
Shoqata të autorizuara	2448	1079	1342	1544	93	35	732	4	0	31
Klinikat juridike	194	111	83	48	15	4	113	0	0	0
Totali	5972	3105	2741	3455	839	271	1102	9	0	46


\*Pasqyrë tabelore e të dhënave për numër total të personave që kanë marrë ndihmë juridike falas.

Në vitin 2022 përmes seksioneve rajonale, shoqatave të autorizuara dhe klinikave juridike, gjithsej 5972 kanë marrë ndihmë juridike parësore, nga të cilat 3105 kanë qenë meshkuj dhe 2741 kanë qenë gra.

Në vitin 2022, në Seksionet rajonale për Ndihmë Juridike Falas të Ministrisë së Drejtësisë, ndihmë juridike parësore kanë marrë gjithsej 3330 persona, nga të cilët 1915 meshkuj, 1316 femra. Pasqyrë tabelore e të dhënave statistikore për numrin total të personave që kanë marrë ndihmë juridike parësore sipas seksioneve rajonale është paraqitur në Aneksin 2 - Tabela nr. 1.1 Seksionet rajonale nga ky raport.



Nga numri total i personave (3330) që kanë marrë ndihmë juridike falas në vitin 2022 në seksionet rajonale, 1863 kanë qenë nga përkatësia etnike maqedonase, 731 persona nga përkatësia etnike shqiptare, 232 persona nga përkatësia etnike turke, 257 persona nga përkatësia etnike rome dhe 5 persona nga kombësia serbe dhe 15 persona nga përkatësia tjetër etnike.



Sipas raporteve të ofruesve të ndihmës juridike falas, kërkesat më të shpeshta të parashtuara për ndihmë juridike parësore në vitin 2022 janë në fushën e: çështjeve pronësore-juridike, divorcit, shqiptimit të masave për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, mbrojtjes së fëmijëve, përcaktimit të atësisë etj.






**Shoqatat e autorizuar** që ofrojnë ndihmë juridike falas regjistrohen në Regjistrin e Shoqatave për Ndihmë Juridike Falas të Ministrisë së Drejtësisë. Gjithsej 15 shoqata janë të regjistruara në Regjistrin e Shoqatave për ndihmë juridike falas.

Në pajtim me nenin 8 paragrafi 7 i Ligjit për ndihmën juridike falas (“Gazeta e RMV-së” nr. 101/19) “Shoqata është e obliguar të dorëzojë raporte mujore në Ministri për të dhënat që kanë të bëjnë me ndihmën e ofruar juridike parësore”.

Në vitin 2022, gjithsej 13 (trembëdhjetë) shoqata kanë dorëzuar raporte për ofrimin e ndihmës juridike parësore në Seksionin për Ndihmë Juridike Falas. Përmes shoqatave të autorizuar ndihmë juridike parësore kanë marrë gjithsej 2448 persona, prej të cilëve 1079 janë meshkuj dhe 1342 femra.




**Shtojca 3** e këtij raporti e prezantuar në tabelën (**Tabela nr. 1.2 Shoqatat e Autorizuara**) me të dhënat statistikore për numrin e përgjithshëm të personave që kanë marrë ndihmë juridike parësore dhe kanë paraqitur kërkesa për ndihmë juridike dytësore në Shoqatat e Autorizuara.

**Klinikat juridike** që ofrojnë ndihmë juridike falas regjistrohen nga Ministria e Drejtësisë dhe publikohen në faqen e internetit të Ministrisë në Regjistrin e Klinikave juridike. Gjithsej 7 (gjashtë) Klinika juridike janë të regjistruara në Regjistrin e juridike, në vitin 2022 është regjistruar një klinikë e re juridike.

Në vitin 2022, gjithsej 3 (tre) Klinika juridike kanë dorëzuar raport në Seksionin për Ndihmë Juridike Falas – Ministria e Drejtësisë. Ndihmë juridike parësore kanë marrë gjithsej 194 persona, prej të cilëve 111 janë meshkuj dhe 83 femra.

Ndërsa 4 (katër) klinikat tjera juridike të regjistruara në Regjistrin e Klinikave juridike për ofrimin e ndihmës juridike parësore pranë Ministrisë së Drejtësisë nuk kanë dorëzuar raporte/të dhëna në Seksionin për Ndihmë Juridike Falas.



Në **Aneksin 4** të këtij raporti është paraqitur tabelë (**Tabela nr. 1.3 Klinikat juridike**) me të dhënat statistikore për numrin total të personave që kanë marrë Ndhimë juridike parëse dhe të kërkesave të parashtruara për ndihmë juridike dytësore në Klinikat juridike.



## Ndihma dytësore juridike

Ndihma juridike dytësore i jepet personit që ka nevojë për ndihmë juridike profesionale nga avokati për një çështje të caktuar juridike dhe i cili për shkak të gjendjes së tij financiare nuk është në gjendje të paguajë shpenzimet e procedurës dhe kërkesa e të cilit është e justifikuar. Ndihma juridike dytësore miratohet ose refuzohet nga një person i autorizuar nga Seksioni rajonal për ndihmë juridike falas.

Në periudhën 01.01.-31.12.2022 janë paraqitur gjithsej 291 kërkesa për ndihmë juridike dytësore.

- Janë miratuar 231 kërkesa, janë refuzuar 40 kërkesa
- Janë marrë 15 aktvendime për ndërprerjen e ndihmës e miratuar juridike dytësore

## 2. Ndihma juridike dytësore (numri total)

Tabela nr.2

	2021	2022
Numri i kërkesave të parashtruara	295	291
Numri i kërkesave të miratuara	203	231
Numri i kërkesave të refuzuara	65	40
Numri i aktvendimeve të miratuara me të cilën ndërpritet ndihma e miratuar juridike dytësore <sup>2</sup>	13	15

<sup>2</sup> Në bazë të nenit 26 paragrafi 1 të Ligjit për Ndihmën Juridike Falas ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 101/19): Ministria do të sjellë aktvendim me të cilin ndërpritet ndihma e miratuar juridike dytësore në rastet në vijim: - me kërkesë të shfrytëzuesit, - kur shfrytëzuesi i ndihmës juridike ka vdekur, përveç nëse të gjithë anëtarët e familjes së tij me të cilët ka jetuar në një familje të përbashkët i plotësojnë kushtet për miratimin e ndihmës juridike dytësore dhe kanë interes juridik për zgjidhjen e çështjes juridike, janë të gatshëm të vazhdojnë procedurën në të cilën është miratuar ndihma juridike dhe nëse është çështje juridike që mund të trashëgohet dhe që përfaqëson shfrytëzuesin në procedurë e njoftojnë Ministrinë në një afat prej 15 ditësh nga dita e vdekjes së shfrytëzuesit, - nëse avokati ka paraqitur mendim të arsyetuar se është e papërshtatshme dhënia e ndihmës juridike dytësore, - kur përfituesi, për shkaqe të pajustificuara dhe në vazhdimësi, nuk takohet me avokatin në kohën dhe vendin e rënë dakord paraprakisht dhe për këtë nuk e ka njoftuar avokatin ose refuzon të bashkëpunojë në procesin e marrjes së ndihmës juridike dytësore ose në procesin e dhënies së ndihmës juridike dytësore, - nëse konstatohet se shfrytëzuesi pas miratimit të aktvendimit për miratimin e ndihmës juridike dytësore nuk i plotëson kushtet për miratimin e ndihmës juridike dytësore të përcaktuara me Pjesën 3 kreu II të këtij ligji, - nëse konstatohet se shpenzimet e ndihmës juridike dytësore të miratuar janë shumë më të larta në krahasim me vlerën e kontestit ose - nëse gjatë periudhës së shfrytëzimit të ndihmës juridike dytësore - konstatohet se shfrytëzuesi ka dhënë të dhëna të rreme për të marrë ndihmë juridike dytësore.



Në pajtim me raportet e Seksioneve rajonale të ndihmës juridike falas të Ministrisë së Drejtësisë kërkesat më shpesh të parashtruara për ndihmë juridike falas në vitin 2022 janë nga sfera e: çështjeve pronësore-juridike, divorcit, shqiptimit të masave për mbrojtje të viktimave nga dhuna në familje, mbrojtja e fëmijëve, përcaktimi i atësisë etj.

Në **Aneksin 5** të këtij raporti është paraqitur pasqyrë e kërkesave të parashtruara për ndihmë juridike dytësore sipas seksionit rajonal në **Tabelën nr. 2.1**.

## Tregime të suksesshme

### 1. Tregim i suksesshëm në lidhje me procedurën e trashëgimisë

Kërkuesja për ndihmë juridike falas S.J. nga Shkupi ka qenë person me pronësi të dobët dhe për një kohë të gjatë nuk ka mundur ta trashëgojë pronën nga bashkëshorti i saj i ndjerë për shkak se nuk ka pasur mjete për të paguar avokat. Pasi iu është drejtuar Drejtorisë Rajonale Kisella Vodë të Ministrisë së Drejtësisë, i është miratuar ndihmë juridike dytësore, përkatësisht avokati A.R. ta përfaqësojë atë në procedurën e trashëgimisë para një noteri. Avokati ka paraqitur propozim për zgjidhjen e trashëgimisë më 5 janar 2023 dhe tashmë më 6 shkurt 2023, Noteri V.G. nga Shkupi, ka sjellë aktvendim me të cilin është zgjidhur trashëgimia dhe prona është bartur në emër të parashtrueses. Me këtë, pala me pronë të dobët S.J ka fituar pronë dhe nuk është më me statusin e të ardhurave të ulëta. E ka zgjidhur çështjen e saj banesore dhe pronësore.

### 2. Tregim i suksesshëm nga e drejta familjare

Kërkuesja për ndihmë juridike falas R.B. nga Shkupi, ajo për shkak të prishjes së marrëdhënieve martesore për një kohë të gjatë ka jetuar e ndarë nga bashkëshorti dhe nuk ka pasur mundësi të përfitojë nga të drejtat e mbrojtjes sociale, pasi është e regjistruar si person i martuar. Ajo nuk ka mundur të ndajë mjete për avokat për ta përfaqësuar në një procedurë divorci për shkak se ka qenë me të ardhura të ulëta, kështu që iu është drejtuar Seksionit rajonal të Ministrisë së Drejtësisë, Gazi Babë, pas së cilës iu është miratuar ndihmë juridike dytësore - avokat që do përfaqësojë atë në procedurë divorci. Procedura përfundoi me sukses, martesa u divorcua dhe kërkuesja si person i pavarur është paraqitur para organeve të Qendrave për Punë Sociale dhe i ka realizuar të drejtat e saj sociale.



### 3. Tregim i suksesshëm nga procedura jashtëkontestimore

Kërkuesi i NJF, personi E.M. nga Tetova, shumë vitesh ka pasur problemin e dëshmisë së atësisë së tre fëmijëve të saj, pasi në certifikatën e lindjes ka qëndruar emri i bashkëshortit të saj të parë, me të cilin nuk është divorcuar dhe nuk ka jetuar jetonte me të për 15 vite. Fëmijët kanë lindur jashtë martese me burrin e saj të dytë. Pasi iu është drejtuar S.R.Tetovë i është miratuar ndihmë juridike dytësore/është caktuar avokat J.T. nga Tetova, i cili me datë 02.12.2021 ka paraqitur padi në gjykatën kompetente për vërtetimin e atësisë së tre fëmijëve të mitur. Në datën 29 qershor 2022, tashmë iu është miratuar vendim i formës së prerë, me të cilin është përcaktuar atësia e fëmijëve dhe në certifikatat e lindjes, në rubrikën "babai" është shënuar emri i babait të tyre të vërtetë biologjik.

*Seksioni për ndihmë juridike falas në Ministrinë e Drejtësisë shënon 85% tregime të suksesshme nga gjithsej 291 kërkesa të paraqitura për ndihmë juridike dytësore.*

*Të gjitha këto tregime të suksesshme dëshmojnë për punë dhe funksionimin e suksesshëm të sistemit për ndihmë juridike falas në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe për cilësinë e punës së punëtorëve në Ministri dhe në Seksionet rajonale.*

#### Buxheti dhe të dhënat financiare

Me buxhetin e Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2022, janë miratuar mjete/buxhet për ndihmë juridike falas për vitin 2022 dhe janë 5.000.000,00 denarë. Buxheti vjetor i realizuar për ndihmë juridike falas në vitin 2022 është 3.974.558,00 denarë.

Në bazë të vendimeve, në vitin 2022 janë paguar mjete në shumë prej 1.710.008,00 denarë avokatëve dhe shoqërive të avokatëve, ndërsa në vitin 2021 shoqatave u janë paguar mjete në shumë prej 26.250,00 denarë.

Me buxhetin e Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2022 janë siguruar mjete në vlerë prej 5.000.000,00 denarë për NJF, në llogarinë buxhetore 637 - Programi 10 Administrata - Zëri 425 Shërbimet kontraktuale.



## Ekipimi teknik



Gjatë vitit 2022, përmes projektit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës për ["Mbështetje për qasje më të mirë në shërbime më cilësore për ndihmë juridike falas në Maqedoninë e Veriut"](#), Seksionit për ndihmë falas dhe seksioneve rajonale të Ministrisë së Drejtësisë iu dhuruan 25 laptopë dhe 5 printerë multifunksionalë. Në të kaluarën, drejtoritë rajonale janë përballur me pengesa në punën e tyre për shkak të mungesës së pajisjeve të përshtatshme teknike për kryerjen e punës së tyre të përditshme, dhe dhurimi i këtyre 25 laptopëve do të kontribuojë shumë në eliminimin e këtij problemi dhe forcimin e efikasitetit dhe cilësisë në ofrimin e shërbime për ndihmë juridike falas.

## Ndarja e mjeteve financiare për dhënie të ndihmës juridike parësore nga shoqatat e autorizuara dhe klinikat juridike

Në pajtim me nenin 11 paragrafi 2 të Ligjit për Ndihmë Juridike Falas (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr. 101/19 nga 22.05.2019), ministri shpalli konkurs publik për ndarjen e mjeteve financiare për sigurimin e mjeteve financiare për dhënie të ndihmës juridike parësore nga shoqatat e autorizuara dhe klinikat juridike.

Ministria e Drejtësisë, në bazë të procedurës së zhvilluar, sipas prioritetit të cekur në konkursin publik, përkatësisht komunat që përfshijnë aplikantët sipas projektit për implementim, vendosi që shtatë (7) kandidatët e parë nga ranglista të marrin mjete financiar për ofrimin e ndihmës juridike parësore nga klinikat e autorizuara dhe juridike, në vlerë prej 150.000,00 denarë, në vlerë të përgjithshme prej 1.050.000,00 denarë nga llogaria e rregullt buxhetore e Ministrisë së drejtësisë 634, Programi 10, zëri 425, mjete të parapara në Buxhetin e Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2022, sipas raportit nga procedura e zhvilluar dhe në përputhje me nenin 11 të LNJF.



- 1. Qendra Kulturore Rinore - Manastir**
- 2. Shoqata Qendra Nacionale Rome - Kumanovë**
- 3. Shoqata EHO Organizata Edukative - Humanitare Shtip**
- 4. Klinika Juridike Emine Zendeli, Fakulteti Juridik në Universitetin e Evropës Juglindore, Tetovë.**
- 5. Shoqata Organizata joqeveritare Kham Dellçevë**
- 6. Shoqata Hops - Opsione për jetë të shëndetshme Shkup**
- 7. Goce Dellçev- Fakulteti Juridik Shtip**

#### **1. Emërtimi i shoqatës Qendra Kulturore Rinore (QKM Manastir)**

Titulli i projektit: Qasje e barabartë në drejtësi për qytetarët e rajonit të Pellagonisë.

Numri i marrëveshjes për ndarjen e mjeteve financiare: 1158/16 nga 01.07.2022

Qyteti, rajoni planor ku realizohet projekti: Rajoni i Pellagonisë (Manastir, Demir Hisar, Mogillë dhe Novacë)

Buxheti i miratuar: 150.000.000 denarë

Rezultatet:

1. Rezultati i arritur: Ndhimë e siguruar parësore juridike për 103 qytetarë, prej të cilëve 20 qytetarë nga komunat Demir Hisar, Novacë, Mogillë, Prilep dhe Ohër;
2. Rezultati i arritur: Informim i rritur te qytetarët për të drejtat, detyrimet dhe mënyrat e mbrojtjes së tyre në rajonin e Pellagonisë (komuna Demir Hisar, Novacë dhe Mogillë);
3. Rezultati i arritur: Informim i rritur te qytetarët për ligjin për ndihmë juridike falas në rajonin e Pellagonisë (komunat Manastir, Demir Hisar, Mogillë dhe Novacë);
4. Rezultati i arritur: Informim i rritur te qytetarët për të drejtën e ndihmës juridike falas dhe shfrytëzimin më masiv të saj;
5. Rezultati i arritur: Bashkëpunim i përmirësuar me komunat, organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet me qëllim të qasjes më të mirë në drejtësi për grupet e synuara.



## 2. Titulli i shoqatës: Shoqata “Qendra Nazionale Rome” Kumanovë

Titulli i projektit: Procese Juridike – DREJTËSI, respekt dhe besim

Qyteti, rajoni i planit ku implementohet projekti: Kumanovë, Rankovcë, Kriva Pallankë

Buxheti i miratuar: 150 000, oo denarë

Rezultate:

1. Ndhmë e ofruar parësore për 116 persona
2. Janë parashtruar 5 kërkesa për ndihmë juridike dytësore.

## 3. Emërtimi i Shoqatës EHO Organizata Edukative - Humanitare Shtip

Titulli i projektit: Avancimi i qasjes në drejtësi për qytetarët në Rajonin e Pellagonisë

Qyteti, rajoni i planit ku implementohet projekti: Komunat e Prilepit dhe Krushevës dhe Shtipit

Buxheti i miratuar: 150.000.000 denarë

Rezultatet:

1. Ndhmë juridike falas kanë marrë 71 qytetarë;
2. Gjithsej 106 qytetarë kanë marrë ndihmë juridike parësore në të tri format;
3. Janë realizuar gjithsej pesë ditë të hapura informative duke vendosur pikë informative në ambient të hapur, publik dhe të aksesueshëm dhe shpërndarje të torbave promovuese dhe fletushkave informative nga ekipi i projektit, nga të cilat 4 u mbajtën në Prilep dhe 1 në Krushevë;
4. Rreth 500 qytetarë morën materiale informative në këto ditë të hapura;
5. U publikuan gjithsej 19 përmbajtje, nga të cilat 5 të sponsorizuara, me gjithsej 31791 përdorues të rrjeteve sociale dhe 2837 angazhime;
6. Shpërndarja e materialeve informative dhe promovuese për institucionet vendore dhe shoqatat civile;
7. U organizuan dy sesione për edukimin juridik të qytetarëve vulnerabil social në komunat e Prilepit dhe Krushevës.





#### **4. Emërtimi i shoqatës ose Fakulteti Juridik: Klinika Juridike Emine Zendeli, Fakulteti Juridik, Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë.**

Titulli i projektit: Ndhimë juridike falas, sfidat dhe zgjidhjet

Qyteti, rajoni i planit ku implementohet projekti: Tetovë dhe Gostivar dhe zonat rurale

Buxheti i miratuar: 150.000.000 denarë

Rezultatet:

1. Promovimi i Klinikës Juridike në rajonin e Tetovës;
2. Vendosja e bashkëpunimit me organizatën joqeveritare Shoqata për Afirmimin e Grave, Rrjeti Nacional kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, Qendra e Grave për Mbështetje-Tetovë;
3. Punë e drejtpërdrejtë me gratë dhe fëmijët viktime të dhunës në familje;
4. Mjetet e dhuruara për Klinikën juridike janë dhënë për qëllime humanitare për strehimin e grave dhe fëmijëve viktime të dhunës në familje

#### **5. Emërtimi i shoqatës: Organizata joqeveritare KHAM Dellçevë**

Titulli i projektit: Qasje në ndihmën juridike falas

Qyteti, rajoni i planit ku realizohet projekti: Dellçevë, rajoni i planit lindor

Buxheti i miratuar: 150.000.000 denarë

Rezultatet:

1. Numri i rritur i grave që kanë kërkuar shërbim - Ndhimë juridike falas;
2. Janë prezantuar rezultatet e organizatës në ofrimin e ndihmës parësore juridike falas për qytetarët e Dellçevës;
3. Qasje të vazhdueshme të qytetarëve nga kategoritë vulnerabile në shërbimin e ndihmës juridike falas
4. Informimi i vazhdueshëm i qytetarëve për shërbimin e ndihmës juridike falas në sinergji me programet dhe projektet që OJQ "KHAM" Dellçevë i realizon gjatë vitit 2022;
5. Besimi i rritur në KHAM si organizatë që i mbron të drejtat e grave dhe grupeve të marginalizuara.



## 6. Emërtimi i shoqatës Hops - Opsione për jetë të shëndetshme Shkup

Titulli i projektit: Avancimi i të drejtës së qasjes në drejtësi të personave fizikë, me fokus të veçantë për personat që përdorin drogë, punëtorët seksualë dhe familjet e tyre duke ofruar ndihmë juridike parësore falas.

Qyteti, rajoni i planit ku implementohet projekti: Shkup, vendbanimi Shuto Orizari

Buxheti i miratuar: 150.000.000 denarë

Rezultatet:

1. Informim i rritur i popullatës në komunën e Shuto Orizarit, përfshirë personat që përdorin drogë dhe punëtorët seksualë që jetojnë në komunën e Shuto Orizarit, për: ndihmën juridike parësore në pajtim me LNJF; për ndihmën juridike dytësore falas që e ofron shteti, përkatësisht për mënyrën dhe kushtet që duhet të plotësohen për të marrë ndihmë juridike dytësore; për cilat procedura mund të marrin ndihmë juridike dytësore; për mundësinë e shërbimeve juridike falas;
2. Përmes informimit, e promovuam me sukses NJF në përputhje me LNJF. 3. Është dhënë edhe ndihmë juridike falas në përputhje me LNJF për popullsinë në komunën e Shuto Orizarit, përfshirë edhe njerëzit që përdorin droga dhe punëtorët seksualë..

## 7. Emërtimi i shoqatës ose Fakulteti Juridik: **Klinika Juridike e Fakulteitt Juridik - Goce Dellçev-Universiteti "Goce Dellçev" - Shtip**

Titulli i projektit: Klinika juridike mobile

Qyteti, rajoni i planit ku implementohet projekti: Karbincë, Çeshinovë-Obleshevë dhe zonat rurale në Komunën e Shtipit.

Buxheti i miratuar: 150.000.000 denarë

Rezultatet:

1. Janë formuar 3 (tre) ekipe me nga dy studentë secili për vizita në terren;
2. Është krijuar bashkëpunim me 4 (katër) komuna, me nënshkrimin e memorandumit të bashkëpunimit (komuna e Karbincit, komuna e Çeshinovë-Obleshevës, komuna e Vallandovës, komuna e Shtipit);
3. Administrata e informuar në komunën e Çeshinovës-Obleshevës dhe komunës së Karbincit për sistemin e ndihmës juridike falas;



4. 87 kopje të shtypura dhe të shpërndara të fletushkave/broshurës informative me informacione për ndihmën juridike falas dhe informacione për Klinikën Juridike si ofrues i autorizuar i ndihmës juridike parësore;
5. Qytetarë të informuar nga komunat më të vogla dhe zonat rurale për sistemin e ndihmës juridike falas dhe ekzistimin e klinikës juridike si ofrues i autorizuar i ndihmës juridike falas;
6. Përmirësimi i aksesit në ndihmë juridike falas;
7. Ndihmë juridike parësore i është ofruar 21 përfituesve të ndihmës parësore juridike, nga të cilët 13 janë gra dhe 8 janë burra;
8. Kapacitete të forcuara për praktikimin e të drejtës tek 6 (gjashtë) studentë, nga të cilët 5 janë femra dhe 1 mashkull.



## Aktivitetet për promovimin dhe informimin e publikut për ndihmën juridike falas

### ❖ Fushata për ndërgjegjësimin për ndihmën juridike falas

Fushata për ndërgjegjësimin e qytetarëve të Maqedonisë së Veriut për ndihmën juridike falas, e zbatuar nga Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me projektin e Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës, [Mbështetja për qasjen më të mirë në shërbimet më cilësore për ndihmën juridike falas në Maqedoninë e Veriut](#), e cila filloi në tetor 2020, vazhdoi edhe gjatë gjithë vitit 2022 dhe arriti në më shumë se 500,000 qytetarë, duke i informuar për rëndësinë, disponueshmërinë dhe funksionimin e sistemit të ndihmës juridike falas.

Fushata ka për qëllim të promovojë sistemin e ndihmës juridike falas si mekanizëm të rëndësishëm për mbrojtjen juridike të kategorive vulnerable të qytetarëve dhe si obligim i shtetit për të siguruar qasje të barabartë në drejtësinë për të gjithë qytetarët që nuk mund ta lejojnë atë.

Materialet e ndryshme promovuese (fletushka, postera, broshura, [video animacioni](#) dhe materialet e tjera informative) janë përpiluar dhe shpërndarë në më shumë se 233 institucione dhe janë të disponueshme në më shumë gjuhë (gjuhë maqedonase, shqipe, turke dhe rome). Materialet informative janë të disponueshme edhe në Alfabetin e Brajlit për personat e verbër dhe me shikim të dëmtuar. Reklama për ndihmën juridike falas ishte vendosur në dy autobusë dykatësh të NQP Shkup (numri 22a Vodno - Vollkovë dhe numër 57 Kozle - Radishani).





Gjatë vitit 2022 janë mbajtur 12 mikro-promovime në formën e aktiviteteve promovuese në qytete dhe zona të ndryshme rurale, përmes të cilave qytetarët ishin informuar drejtpërdrejt për të drejtën e ndihmës juridike falas. U organizuan promovimet me stenda informative të vendosura në vendet ku zakonisht lëvizin qytetarët. Këto promovime janë veçanërisht të rëndësishme sepse promovimet tradicionale dhe online nuk mund të arrijnë gjithmonë te të gjitha grupet e qytetarëve.

*\*Tabela me lokacionet ku janë mbajtur promovimet*

	Komuniteti lokal	Data e promovimit
1.	Promovimi në Komunën e Vinicës	13 korrik 2022
2.	Promovimi në Komunën e Koçanit + Obleshevës	14 korrik 2022
3.	Promovimi në Komunën e Shtipit + Llozovës	22 korrik 2022
4.	Promovimi në Komunën e Shuto Orizarës	23 korrik 2022
5.	Promovimi në Komunën e Dojranit + Komunën e Strumicës	25 korrik 2022
6.	Promovimi në Komunën e Manastirit + Komunën e Mogillës	29 korrik 2022
7.	Promovimi në Komunën e Prilepit dhe Komunën e Krivogashtanit	30 korrik 2022
8.	Promovimi në Komunën e Kumanovës dhe Komunën e Novo Sellës	11 gusht 2022
9.	Promovimi në Komunën e Ohrit dhe Peshtanit	13 gusht 2022
10.	Promovimi në Komunën e Strugës dhe Dellogzhdës	14 gusht 2022
11.	Promovimi në Komunën e Tetovës dhe Bërvenicës	18 gusht 2022
12.	Promovimi në Komunën e Dellçevës	20 gusht 2022

Gjithsej, rreth 4,000 qytetarë u informuan (60% gra, 40% burra) për ndihmën juridike falas.



Qytetarët mund të marrin informacione për ndihmën juridike falas edhe në faqen e internetit: <http://www.pravnapomos.mk/> si dhe në faqen e Fejsbukut [Ndihma juridike falas](#) që funksionojnë si platformë ku qytetarët mund të marrin më shumë informacione për kushtet dhe llojin e çështjeve juridike për të cilat mund të sigurohet ndihma juridike falas.

Natyra inkluzive e fushatës dhe përpjekjet e kombinuara të faktorëve të ndryshëm në sistemin e ndihmës juridike falas (Ministria e Drejtësisë, Oda e Avokatëve, shoqatat e autorizuara të qytetarëve dhe klinikat juridike) do të çojnë në rritje edhe më të madhe të kërkesave për ndihmën juridike falas nga qytetarët të

cilët nuk janë në gjendje të lejojnë ndihmën juridike për shkak të gjendjes së tyre ekonomike.



Përpjekjet e intensifikuara të Ministrisë së Drejtësisë së bashku me të gjithë faktorët ishin shënuar edhe në Raportin e Progresit të [Komisionit Evropian për Maqedoninë e Veriut për vitin 2022](#)

### ❖ *Shënimi i Ditës Evropiane të Drejtësisë - Dy vjet nga nisja e fushatës për ndërgjegjësimin për ndihmën juridike falas*

Dita Evropiane e Drejtësisë 2022 u shënuar me konferencën në nivelin e lartë, e organizuar në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe e mbështetur nga projekti i përbashkët i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës, "[Mbështetja për qasjen më të mirë në shërbimet më cilësore për ndihmën juridike falas në Maqedoninë e Veriut](#)". Në konferencë u prezantuan rezultatet e fushatës për ndërgjegjësimin për ndihmën juridike falas në Maqedoninë e Veriut. Rreth 100 përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë dhe departamentet dhe zyrat e saj rajonale, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shoqërisë civile, klinikat juridike dhe juristët e avokatët e tjerë u mbledhën në një vend për t'i shkëmbyer



mendimet e tyre, për të theksuar suksesin dhe sfidat që lidhen me përpjekjet për rritjen e qasjes në drejtësinë për qytetarët.



Evenimentin e hapi ministri i Drejtësisë, Nikolla Tupançeski, i cili theksoi se të gjithë qytetarët duhet të kenë qasje të garantuar në drejtësi dhe gjykim të drejtë. *“Sistemi i ndihmës juridike falas garanton që qytetarët që janë në gjendje të vështirë financiare mund t’u drejtohen ofruesve të ndihmës juridike dhe të kërkojnë ndihmë juridike dhe avokat të financuar nga shteti. Drejtësia e vonuar është drejtësi e mohuar”* theksoi Tupançeski. Përveç ministrit të Drejtësisë, fjalime kishin edhe Kristof Poarel - drejtor i Drejtorisë për të Drejtat e Njeriut në Këshillin e Evropës, Mari-Madelin Kanalopulou - drejtoreshë operative në Delegacionin e BE-së në Shkup dhe Lubomir Mihajllovski - kryetar i Odës së Avokatëve, i cili e theksoi rëndësinë e rolit të avokatëve në ofrimin e ndihmës juridike falas, duke theksuar se avokatët kanë përgjegjësi për t’u ndihmuar qytetarëve që të marrin drejtësi. Evenimenti u mbulua nga media dhe 55 artikuj u publikuan në mediat elektronike.

## Trupi Koordinues Kombëtar për zbatimin e Ligjit për ndihmën juridike falas

Trupi Koordinues Kombëtar për zbatimin e Ligjit për ndihmën juridike falas (TKK) gjatë vitit 2022 ka mbajtur tri mbledhje (28 shkurt 2022, 20 qershor 2022 dhe 7 tetor 2022) ku janë diskutuar temat me rëndësi për zbatimin e Ligjit për ndihmën juridike falas - arritjet dhe sfidat. U diskutuan temat e rëndësishme në lidhje me përvojat dhe sfidat lidhur me qasjen në ndihmën juridike për viktimat e dhunës në familje, si dhe nevojën e bashkëpunimit në ofrimin e ndihmës juridike për personat që janë pjesëtarë



të komunitetit etnik rom. Në mbledhjen e dhjetë të TKK-së, që u mbajt më 7 tetor 2022, u diskutuan edhe propozimet konkrete për ndryshimet në Ligjin për ndihmën juridike falas, që u bënë pjesë e [Analizës së](#)



[Ligjit për ndihmën juridike falas: Rekomandimet për përmirësimin e kornizës ligjore dhe politikave për ndihmën juridike falas në çështjet civile dhe administrative në Maqedoninë e Veriut](#) si dhe

u diskutua mundësia e vendosjes së një trupi për të menaxhuar sistemin e ndihmës juridike falas.

Trupi Koordinues Kombëtar për zbatimin e Ligjit për ndihmën juridike falas (TKK) u formua në janar 2020 me mbështetjen e projektit të

lartpërmendur të Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian" si forum për shkëmbimin e informacioneve, komunikimit dhe koordinimit ndërmjet palëve të interesuara për temat me rëndësi për zbatimin e Ligjit për ndihmën juridike falas dhe lehtësimin e qasjes në drejtësi në nivel kombëtar.







## Trajnimet e punonjësve

Në janar 2022, në kuadër të projektit të lartpërmendur të Bashkimit Evropian / Këshillit të Evropës, u mbajt trajnimi tregitor i trajnuesve për ndihmën juridike falas për punonjësit e departamenteve / zyrove rajonale, në kuadër të të cilit u trajnuan 16 përfaqësues nga departamentet / zyrat rajonale. Dy trajnimet tregitore kaskade për ndihmën juridike falas për punonjësit në departamentet rajonale u mbajtën në prill (nga 13 deri më 15) dhe në maj (nga 9 deri më 11) 2022. Trajnimet kaskade i forcuan kapacitetet e rreth 50 punonjësve në departamentet / zyrat rajonale të Ministrisë së Drejtësisë për ofrimin më efektiv të ndihmës juridike falas veçanërisht për kategoritë vulnerabile, me vështrim të veçantë për viktimat e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Gjithashtu, trajnimet kontribuan për përfshirjen më të madhe të departamenteve / zyrove rajonale në promovimin e rëndësisë së ndihmës juridike falas.





Trajnimi për zbatimin e nenit 11 të Ligjit për ndihmën juridike falas, në lidhje me ndarjen e mjeteve financiare për shoqatat e qytetarëve dhe klinikat juridike të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike primare, ishte mbajtur më 18 janar 2022 për punonjësit e Ministrisë së Drejtësisë të cilët më vonë morën pjesë në grupin e punës për zbatimin e procedurës. [“Udhëzimet për procedurën e ndarjes së mbështetjes financiare për shoqatat e qytetarëve dhe klinikat juridike të autorizuara”](#) të zhvilluara nga konsulentët e Këshillit të Evropës u prezantuan në trajnim, i cili ishte jashtëzakonisht i rëndësishëm për punonjësit që zbatuan procedurën. Rekomandimet e Këshillit të Evropës u zbatuan me sukses në zbatimin e gjithë procedurës për herë të parë pas miratimit të Ligjit për ndihmën juridike falas të vitit 2019.

Punonjësit e Departamentit të Ndhmës Juridike Falas më 30 mars dhe 1 prill 2022, u trajnuan mbi praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në lidhje me të drejtën për ndihmën juridike falas në lëndët civile dhe administrative. Në të njëjtin trajnim (i mbështetur nga projekti i Këshillit të Evropës / Bashkimit Evropian) u forcuan kapacitetet e punonjësve në drejtim të mbledhjes, përpunimit dhe analizimit të të dhënave, sigurimit të mirëqenies, uljes së stresit dhe mbingarkimit nga puna. Në mënyrë plotësuese, punonjësit në Departament si dhe në departamentet rajonale patën mundësinë të diskutojnë dhe të këshillohen lidhur me zbatimin praktik të disa dispozitave të Ligjit për ndihmën juridike falas.



Më 28 dhe 29 nëntor 2022, u mbajt trajnimi dyditor mbi qasjen në drejtësi në lëndët e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore për departamentet rajonale të Ministrisë së Drejtësisë dhe Qendrave për Punë Sociale, të organizuar bashkërisht në kuadër të projektit të BE/KiE "Mbështetja për qasjen më të mirë në shërbimet më cilësore për ndihmën juridike falas" të zbatuar nga Zyra Programore e Këshillit të Evropës në Shkup dhe projekti "Qasja në drejtësi për më të marginalizuarit" të zbatuar nga Fondacioni Shoqëria e Hapur - Maqedoni, HOPS dhe Stacioni PET, të financuar nga BE-ja.



## Analizat dhe kërkimet

- ❖ Konstatimet dhe rekomandimet nga [studimi i realizueshmërisë \(studimi i fizibilitetit\) për vendosjen e trupit të vetëm për menaxhimin e sistemit të ndihmës juridike falas në Maqedoninë e Veriut](#)

Ndihma juridike për të varfrit në Maqedoninë e Veriut është rregulluar në mënyrë të ndryshme, varësisht nga lloji i çështjes për të cilën ofrohet ndihma juridike. Në çështjet civile dhe administrative ajo jepet në përputhje me Ligjin për ndihmën juridike falas, ndërsa kontrollimi i përmbushjes së kushteve dhe emërtimi i avokatëve bëhet nga Ministria e Drejtësisë. Për personat e akuzuar në procedurat penale, qasja në ndihmën juridike rregullohet me Ligjin për procedurën penale, ndërsa kontrollimi i përmbushjes së kushteve dhe emërtimi i avokatëve bëhet nga gjykatat. Kur bëhet fjalë për fëmijët, vendimtar është Ligji për drejtësinë e fëmijëve, ndërsa procedura varet nga organi përpara të cilit mbahet procedura.

Praktika ka treguar se ka sfida serioze në qasjen në ndihmën juridike. Numri i vogël i personave që e përdorin atë, kushtet restriktive, mënyra jotransparente e emërimit të avokatëve, cilësia e ndihmës juridike si problemet me pagesën e shpërblyerit të avokatëve, me dallime të caktuara, janë të përbashkëta për të gjitha llojet e ndihmës juridike. Në rrethana të tilla, dhe duke i pasur parasysh praktikat krahasuese, lind pyetja nëse është e realizueshme, e nevojshme dhe e dëshirueshme integrimi i sistemeve për ndihmën juridike falas në kompetencë të një trupi të vetëm.

Me qëllim që t'i përgjigjet kësaj pyetjeje, në vitin 2022 ekipi i ekspertëve të Këshillit të Evropës punoi në studimin e realizueshmërisë për vendosjen e trupit të vetëm që do të menaxhojë ndihmën juridike falas në RMV. Në fokusin e studimit ishte të përcaktohet nëse është e realizueshme nga aspekti juridik, operativ dhe financiar menaxhimi i të gjitha sistemeve ekzistuese të ndihmës juridike në procedurën penale, civile dhe administrative t'i besohet një subjekti të veçantë (organi ose trupi). Më tej, çfarë strukture, funksionesh dhe kompetencash do të kishte ky subjekt, si dhe cilat janë hapat që duhet të ndërmerren për zbatimin e kësaj reforme.

Ekipi i ekspertëve përdori një set të ndërlikuar metodash të mbledhjes së të dhënave, duke përfshirë intervistat fillestare me nëntë ekspertë në fushën e ndihmës juridike, intervista të detajuara me faktorët (përfaqësuesit e lartë të gjykatave, Odës së Avokatëve të RMV-së, prokurorët publikë), anketat e pyetësorëve të avokatëve si dhe grupet e fokusit me 7 avokatë dhe 6 gjykatës.

Ekipi konkludoi, në bazë të shumicës së argumenteve të faktorëve relevantë në favor të integritimit. Mendimi dominues është se sistemi i ndihmës juridike duhet të jetë efikas, efektiv dhe t'u përgjigjet nevojave të atyre që kanë nevojë dhe se një nga mënyrat për ta arritur këtë është duke i besuar kompetencën një trupi / organi për të menaxhuar sistemin për ndihmën juridike.

Opsioni më i mirë do të ishte që i vetmi trup që do të menaxhonte të gjithë ndihmën juridike falas në vend të ishte organi shtetëror i mëvetësishëm dhe i pavarur, modeli tashmë i njohur me ligjin në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe i menaxhuar dhe mbikëqyruar nga këshilli i pavarur drejtues. Këshilli drejtues



do të përbëhej nga 8 deri në 15 anëtarë, përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, Odës së Avokatëve, shoqatave, klinikave juridike, gjyqësorit, etj.

Studimi tregoi gjithashtu se integrimi i sistemeve të ndihmës juridike falas është reformë mjaft e ndërlikuar së cilës duhet t'i qaset me kujdes të veçantë, në një proces transparent dhe inkluziv në të cilin do të përfshihen të gjitha subjektet e përfshira në sistemin e ndihmës juridike. Vullneti politik është i domosdoshëm dhe mbështetja profesionale në të gjitha fazat e reformimit. Autorët propozojnë që shteti t'i marrë parasysh konstatimet e studimit në planifikimin strategjik të aktiviteteve në fushën e gjyqësorit. Studimi është i disponueshëm publikisht në këtë [link](#).

- ❖ U zbatua kërkimi i dytë kombëtar për nevojat juridike dhe rrugët në drejtësi - 66% e qytetarëve janë përballur me të paktën një problem juridik në tre vitet e fundit

Në periudhën nga gushti deri në tetor 2022, Këshilli i Evropës, në kuadër të projektit të BE / KiE "Mbështetja për qasjen më të mirë në shërbimet më cilësore për ndihmën juridike falas", nëpërmjet agjencisë së kërkimit të mendimit publik Brima e zbatoi kërkimin e dytë gjithëpërfshirës kombëtar për nevojat juridike dhe rrugët në drejtësi në Maqedoninë e Veriut. Kërkimi u zbatua përmes anketimit telefonik të ekzemplarit të përzgjedhur rastësisht prej 2,800 të anketuarve. Qëllimi i kërkimit ishte identifikimi i problemeve juridike me të cilat përballesh njerëzit që jetojnë në Maqedoninë e Veriut, rrugët për t'i zgjidhur ato dhe grupet demografike që janë veçanërisht të ndjeshme ndaj problemeve juridike.

Sipas konstatimeve, 66% e të anketuarve kanë deklaruar se janë përballur me të paktën një problem juridik i cili nuk ishte trivial në tre vitet e fundit. Të dhënat tregojnë rritje në krahasim me studimin e vitit 2012, ku diçka më pak se gjysma e të anketuarve (49%) kanë deklaruar se kishin përjetuar problem kontestimor. Problemet më të shpeshta të paraqitura kanë të bëjnë me të drejtat e konsumatorëve (20,11%), të ndjekura nga problemet juridike që dalin nga lëndimet dhe problemet shëndetësore (13,95%) si dhe borxhet dhe çështjet që lidhen me marrëdhënien e punës (të dyja nga 11,3%). Në mesin e problemeve të tjera që shpesh paraqiten janë edhe diskriminimi, qasja në ndihmën sociale dhe shërbimet publike dhe pronën. Problemet që më rrallë paraqiten janë kontestet familjare, problemet me policinë, si dhe problemet juridike që lidhen me fëmijët.

Të dhënat treguan se karakteristikat sociodemografike luajnë rol në përcaktimin e përhapjes së problemeve juridike. Një nga faktorët që ndikon në përhapjen e problemeve juridike është moshë. Në përputhje me të dhënat, besueshmëria për të përjetuar problemet juridike ulet me moshën. Gjinia është parashikues modest i besueshmërisë nëse do të përjetohet problemi juridik, pasi 69% e të anketuarve të gjinisë mashkullore kanë paraqitur probleme juridike krahasuar me 63% të të anketuarve të gjinisë femërore. Një faktor shumë më i rëndësishëm është nëse i anketuari jeton në zonën urbane apo rurale.



Personat që jetojnë në zonat rurale kanë 13% pikë përqindje shans më të madh të përjetojnë probleme juridike në krahasim me personat nga zonat urbane. Prejardhja etnike luan rol në përhapjen e problemeve juridike. Të anketuarit nga komuniteti shqiptar paraqesin numër më të madh të problemeve juridike në krahasim me komunitetet e tjera etnike.

Shumica e personave ndërmarrin diçka për t'i zgjidhur problemet e tyre juridike. Pavarësisht kësaj, mund të shihet se 19% kanë thënë se nuk kanë bërë asgjë për të zgjidhur problemin e tyre. Më shumë se 80% e atyre që merren me problemet e konsumatorit kanë kontaktuar palën tjetër; disa kanë kërkuar informacione nga miqtë dhe të afërmit, ndërsa disa preferuan të qëndronin pasivë. Të paktë janë ata që e çuan problemin përpara personit profesionist apo kërkuan rrugë institucionale drejt drejtësisë. *Avokatët përdorëshin më shpesh kur individët zgjidhnin probleme që kishin të bënin me pasuritë e paluajtshme, lëndimet dhe borxhet.* Ekziston besueshmëria më e madhe që njerëzit të mos ndërmarrin asgjë në situatat e ankesave për shërbimet publike, lëndimet dhe problemet e lidhura me shëndetin.

Kërkimi u fokusua edhe në qëndrimet ndaj sistemit të gjyqësorit. Vetëm 3,3 për qind e të anketuarve pajtohen plotësisht me deklaratën se ligjet dhe sistemi i gjyqësorit në Maqedoninë e Veriut janë të drejta. Pothuajse 70% e të anketuarve kanë qëndrim negativ ndaj sistemit të gjyqësorit. Por, pavarësisht kësaj, 1/3 e të anketuarve, gjykatat i konsiderojnë mekanizëm të rëndësishëm për njerëzit e thjeshtë për t'i ushtruar të drejtat e tyre. Një shumicë e madhe e të anketuarve u pajtuan se sistemi gjyqësor funksionon më mirë për të pasurit sesa për të varfrit dhe se shpenzimet e realizimit të drejtësisë janë shumë të larta dhe paraqesin barrë të madhe. Përjetimi i problemeve juridike duket të jetë parashikues i fortë i qëndrimeve, me ç'rast njerëzit që kanë përjetuar probleme juridike ekziston besueshmëri më e madhe të kenë ndjenja negative për sistemin e gjyqësorit në përgjithësi në krahasim me personat që nuk kanë pasur kurrfarë problemesh juridike.

Raporti i detajuar i kërkimit do të bëhet publik gjatë prillit 2023.

- ❖ Rekomandimet për përmirësimin e kornizës ligjore dhe politikave për ndihmën juridike falas në çështjet civile dhe administrative në Maqedoninë e Veriut

Në mbledhjen e dhjetë të Trupit Koordinues Kombëtar për ndihmën juridike falas, e cila u mbajt më 7 tetor 2022, u prezantua dhe u diskutua draft-analiza e zbatimit të Ligjit për ndihmën juridike falas dhe nevojës për ndryshimin e tij. Në fokusin e analizës ishte identifikimi i dispozitave ligjore në Ligjin për ndihmën juridike falas që shkaktuan probleme gjatë aplikimit dhe dhënies së propozimeve dhe rekomandimeve konkrete për draft-ndryshimet e Ligjit. Draft-analiza u përgatit nga ekipi i ekspertëve të Këshillit të Evropës në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë-Departamenti për Ndihmën Juridike Falas dhe departamentet / zyrat rajonale, shoqatat e qytetarëve dhe klinikat juridike të regjistruara për të ofruar ndihmën juridike primare.



Në mbledhje, anëtarët e TKK-së patën mundësinë të komentojnë draft-tekstin e analizës, të prononcohen lidhur me konstatimet dhe rekomandimet, si dhe të propozojnë plotësimin e tekstit. Në mënyrë plotësuese, ishte lënë hapësirë që anëtarët të japin edhe komente me shkrim brenda periudhës së caktuar kohore. Në bazë të propozimeve dhe rekomandimeve të arritura, teksti përfundimtar i analizës u promovua në konferencën përfundimtare të mbajtur më 25 nëntor 2022.

Analiza përmban rekomandime të detajuara dhe gjithëpërfshirëse lidhur me ndihmën juridike primare dhe sekondare, si dhe lidhur me sistemin e përgjithshëm të menaxhimit të ndihmës juridike falas. Ajo duhet të shërbejë si bazë për ndryshimin e ardhshëm të Ligjit, i cili duhet të zbatohet në procesin inkluziv dhe transparent, siç ishte hartuar, në fakt, edhe vetë analiza.

Analiza është e disponueshme publikisht dhe është publikuar në këtë [link](#).

## Anekset

### Aneksi 1

Aktet nënligjore të parashikuara në Ligjin për ndihmën juridike falas janë botuar në ("Gazetën Zyrtare të RMV-së nr. 199/2019").

#### ***a. Aktet nënligjore të ndihmës juridike primare***

1. Rregullorja për formën dhe përmbajtjen e kërkesës për regjistrimin në regjistrin e shoqatave të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike primare dhe në regjistrin e fakulteteve juridike të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike primare
2. Rregullorja për formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit të shoqatave të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike primare dhe regjistrin e fakulteteve juridike të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike primare
3. Rregullorja për kushtet minimale hapësinore dhe teknike që duhet t'i përmbushin shoqatat për t'u regjistruar në regjistrin e shoqatave të autorizuara për të ofruar ndihmën juridike primare
4. Rregullorja për përmbajtjen, formën dhe mënyrën e mbajtjes së evidencës së të dhënave në lidhje me ndihmën juridike primare të ofruar dhe përmbajtjen e raporteve të dorëzuara nga shoqatat dhe klinikat juridike në Ministrinë e Drejtësisë
5. Rregullorja për formularin e listës së shpenzimeve për vëllimin e punës së kryer nga shoqatat dhe klinikat juridike
6. Tarifa për kompensimin e shpenzimeve për punën e shoqatave dhe klinikave juridike për ofrimin e ndihmës juridike primare
7. Rregullorja për mënyrën e shpalljes dhe zbatimit të konkursit publik për ndarjen e mjeteve financiare për dhënie të ndihmës juridike primare shoqatave të autorizuara dhe klinikave juridike që ofrojnë



ndihmën juridike primare, kontrollimin e dokumenteve të parashtruara, mënyrën e marrjes së pikëve gjatë vlerësimit të fletëparaqitjeve dhe kryerjes së kontrollimit të shpenzimit të mjeteve

***b. Aktet nënligjore të ndihmës juridike sekondare***

8. Rregullorja për formën dhe përmbajtjen e kërkesës për ndihmën juridike sekondare
9. Rregullorja për përmbajtjen, formën dhe mënyrën e mbajtjes së evidencës së të dhënave në lidhje me zgjidhjen e kërkesave të parashtruara dhe përmbajtjen e raporteve
10. Rregullorja për mënyrën e veprimit gjatë pranimit të kërkesës për ndihmën juridike sekondare
11. Rregullorja për mënyrën e emërtimit të avokatit

***c. Aktet nënligjore që kanë të bëjnë me avokatët***

12. Rregullorja për formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës për regjistrim në regjistrin e avokatëve për ndihmën juridike sekondare
13. Rregullorja për formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit të avokatëve për ndihmën juridike sekondare
14. Rregullorja për formularin e listës së shpenzimeve për ndihmën juridike sekondare të ofruar nga avokati

***ç. Aktet nënligjore që lidhen me procedurat konkrete për ndihmën juridike***

15. Rregullorja për formularin e listës së shpenzimeve të dorëzuar nga avokati për ndihmën juridike që u ofrohet fëmijëve
16. Rregullorja për formularin e kërkesës për ndihmën juridike falas në procedurën për njohjen e së drejtës për azil
17. Rregullorja për formularin e listës së shpenzimeve për ndihmën juridike sekondare të ofruar nga avokati në procedurën për njohjen e së drejtës për azil





## Aneksi 2

Tabela me të dhënat statistikore për numrin e përgjithshëm të personave që kanë marrë ndihmën juridike primare sipas departamenteve rajonale

Tabela nr. 1.1 Departamentet rajonale

Departamenti Rajonal	Numri i përgjithshëm i personave që kanë marrë NJP	Gjinia		Përkatësia etnike						
		M	F	Maq	Shq	Tur	Rom	Ser	Vlle	Të tjerë
DR Kratovë	23	15	8	21	1	0		1	0	0
DR Kriva Pallankë	97	34	63	81	16	0	0	0	0	0
DR Berovë	78	29	49	71	0	0	7	0	0	0
DR Manastir	57	29	28	49	4	1	0	0	0	3
DR Makedonski Brod	58	48	10	57	0	1	0	0	0	0
DR Vinicë	87	40	47	68	0	0	19	0	0	0
DR Vallandovë	46	20	26	40	0	5	0	1	0	0
DR Gjevgjeli	15	3	12	12	0	0	0	0	0	3
DR Gostivar	42	28	24	6	34	1	1	0	0	0
DR Dibër	32	19	12	2	23	0	8	0	0	0
DR Dellçevë	24	14	10	20	0	2	2	0	0	0
DR Demir Hisar	105	58	47	103	2	0	0	0	0	0
DR Kavadar	94	48	46	78	0	0	16	0	0	0
DR Kërçovë	276	221	55	85	127	24	39	0	0	1
DR Koçani	27	15	12	23	0	0	4	0	0	0
DR Probishtip	26	13	13	23	0	0	3	0	0	0
DR Prilep	40	18	22	36	0	2	2	0	0	0
DR Radovish	150	68	13	63	0	11	7	0	0	0
DR Negotinë	71	32	39	27	54	0	17	0	0	0
DR Ohër	17	10	7	17	0	0	0	0	0	0
DR Resnjë	1019	242	277	535	296	123	65	0	0	0
DR Sveti Nikollë	15	10	5	15	0	0	0	0	0	0
DR Strugë	69	29	40	23	25	16	/	/	/	5
DR Strumicë	229	97	132	183	45	1	0	0	0	0
DR Tetovë	229	132	97	25	199	0	8	0	0	0
DR Kumanovë	42	20	22	31	4	0	5	0	0	0
DR Shtip	64	37	27	48	0	3	10	0	0	3



DR Karposh	129	64	65	105	7	0	14	0	0	0
DR Kisella Vodë	102	32	70	0	0	0	0	0	0	0
DR Gazi Babë	18	6	12	8	1	0	7	1		0
DR Qendër	25	12	13	12	3	0	10	0	0	0
DR Çair	22	10	12	0	0	0	0	0	0	0

## Aneksi 3

Tabela me të dhënat statistikore për numrin e përgjithshëm të personave që kanë marrë ndihmën juridike primare dhe kanë parashtruar kërkesa për ndihmën juridike sekondare në shoqatat e autorizuara

Tabela nr. 1.2 Shoqatat e autorizuara

Shoqata e autorizuar	Numri i përgjithshëm i personave që kanë marrë NJP	Kërkesat e parashtruar a për NJS	Gjinia		Përkatësia etnike						
			M	F	Maq	Shq	Tur	Rom	Ser	Vlle	Tëtjërë
QKR Manastir	184	9	91	93	100	12	1	71	0	0	0
SHMJRR	463	22	178	257	363	12	0	52	1	0	9
QKR Kumanovë	118	1	50	68	10	19	0	97	0	0	2
EHO Shtip	332	13	80	252	258	0	14	39	3	0	18
“IZBOR” Strumicë	82	1	51	31	63	0	17	2	0	0	0
Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut i RMV-së	513	2	265	248	448	37	1	21	0	0	2
Instituti për të Drejtat e Njeriut	43	1	18	25	0	0	0	0	0	0	0



Shoqata e gjykimet të drejtë	28	0	17	11	0	0	0	0	0	0	0
Kham Dellçevë	303	4	16 6	13 7	43	0	0	261	0	0	0
Shoqata Organizata e Grave e Komunës së Sveti Nikollës	150	5	37	11 3	143	0		3	0	0	0
Shoqata Multikultura – Tetovë	29	0	15	14	7	16	6	0	0	0	0
Shoqata HOPS - Opsione për jetë të shëndetshme e Shkup	203	0	11 1	94	109	7	2	87	0	0	0
Shoqata e Forumit të Grave e Tetovës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

#### Aneksi 4

Tabela me të dhënat statistikore për numrin e përgjithshëm të personave që kanë marrë ndihmën juridike primare dhe kanë parashtruar kërkesa për ndihmën juridike sekondare në klinikat juridike

Tabela nr. 1.3 Klinikat juridike

Klinika juridike	Numri i përgjithshëm i personave që kanë marrë NJP	Kërkesat e parashtruar për NJS	Gjinia		Përkatësia etnike						
			M	F	Maq	Shq	Tur	Rom	Ser	Vll e	Të tjerë



Klinika juridike, Fakulteti Juridik, Manastir	142	1	97	47	10	2	0	109	0	0	0
Klinika juridike Universiteti Goce Dellçev Shtip	30	0	13	17	29	0	1	0	0	0	0
Klinika juridike "Emine Zendeli" Tetovë	22	0	1	21	4	13	1	4	0	0	0

#### Aneksi 5

**Tabela nr. 2.1 Pasqyra e kërkesave të parashtruara për ndihmën juridike sekondare sipas departamentit rajonal**<sup>34</sup>

Departamenti Rajonal	Numri i kërkesave të parashtruara	Numri i kërkesave të miratuara	Numri i kërkesave të refuzuara	Në procedurë	Numri i aktvendimeve të miratuara për të cilën ndërpritet NJS
DR Kratovë	0	0	0	0	0
DR Kriva Pallankë	16	14	2	0	0
DR Berovë	13	11	2	0	0
DR Manastir	30	27	2	1	0
DR Makedonski Brod	0	0	0	0	0
DR Vinicë	8	6	2	0	0

<sup>3</sup> Departamentet rajonale për ndihmën juridike falas në komunat në të cilat ka person të autorizuar: DR Berovë, DR Manastir, DR Vallandovë, DR Vinicë, DR Gostivar, DR Dibër, DR Dellçevë, DR Karposh, DR Kisella Vodë, DR Kërçovë, DR Kriva Pallankë, DR Krushevë, DR Kumanovë, DR Negotinë, DR Ohër, DR Resnjë, DR Sveti Nikollë, DR Strugë, DR Tetovë, DR Shtip

<sup>4</sup> Në Departamentet rajonale ku është paraqitur se ka 0 nuk ka persona të autorizuar për vendimarrje, ato i përcjellin lëndët në DR ku ka persona të autorizuar.



DR Vallandovë	32	28	3	0	1
DR Gjevgjeli	0	0	0	0	0
DR Gostivar	3	3	0	0	0
DR Dibër	0	0	0	0	0
DR Dellçevë	1	1	0	0	0
DR Demir Hisar	0	0	0	0	0
DR Kavadar	0	0	0	0	0
DR Kërçovë	6	5	0	0	1
DR Koçani	0	0	0	0	0
DR Probishtip	0	0	0	0	0
DR Prilep	0	0	0	0	0
DR Radovish	0	0	0	0	0
DR Negotinë	21	18	2	0	1
DR Ohër	3	3	0	0	0
DR Resnjë	2	2	0	0	0
DR Sveti Nikollë	7	7	0	0	0
DR Strugë	3	1	1	0	1
DR Strumicë	0	0	0	0	0
DR Tetovë	31	19	6	4	2
DR Kumanovë	25	18	7	0	0
DR Shtip	8	4	4	0	0
DR Karposh	30	20	5	0	5
DR Kisella Vodë	52	44	4	0	4
DR Gazi Babë	0	0	0	0	0
<b>GJITHSEJ</b>	<b>291</b>	<b>231</b>	<b>40</b>	<b>5</b>	<b>15</b>







Ky dokument u prodhuan me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autorit(ve). Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të konsiderohen në asnjë mënyrë se pasqyrojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian apo të Këshillit të Evropës.

Bashkëfinancuar nga  
Bashkimi Evropian



BASHKIMI EVROPIAN

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Bashkëfinancuar dhe zbatuar  
nga Këshilli i Evropës



INFORMOHU  
PËR NDIHMËN  
JURIDIKE FALAS